



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0654

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amendamentuar me datën 09. 08. 2023 në përbërje individuale nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Getno L.L.C", kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Shkopë drite" me numër të prokurimit 214-23-7650-1-3-6, me 01/11/2023, mori:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e OE "Getno L.L.C" me nr. 2023/0654, e datës 04/09/2023, kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Shkopë drite" me numër të prokurimit 214-23-7650-1-3-6, mbetet në fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 21.07.2023 ka publikuar Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Shkopë drite" me nr. të prokurimit: "214-23-7650-1-3-6".

Autoriteti Kontraktues me datën 21. 08. 2023 ka publikuar Njoftimin B58 për anulim të aktivitetit të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 25.08.2023, OE "Getno L.L.C" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK, ndërsa me 29.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Getno L.L.C" i pakënaqur me Njoftimin për anulim të kontratës, me 04.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 654/23.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet vendimi i AK dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Pretendimet e Ankuesit "Getno L.L.C"

- *Pretendimi i pare (I)*- OE ankues pretendon se: “Me dt.21.08.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme, ndërsa neve jemi eliminuar me arsyetimin se: Tek specifikacioni teknik është kërkuar Weight:0.14-0.17 lbs, ndërsa në katalog/broshurë është 20 gram. Pesha “Weight:0.14-0.17 lbs po të konvertohet në gram i bie që 0.14 lbs= 63.50293 gram. Neve me dt.07.08.2023 na është kërkuar sqarime shtesë përmes formularit B47, ku bazuar në nenin 59.2 dhe neni 72 është kërkuar nga ana jonë të sqarojmë dhe dëshmojmë sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, duke dërguar katalogun/broshurën e prodhuesit me përshkrime të specifikacioneve teknike të detajuara duke nënvizuar çdo pozicion në specifikacioneve teknike të kërkuara si ne 4/4 Aneksin 1 në katalog/broshurën e prodhuesit. Duke përfshirë Secure lock hook top; Safe and easy to use Just bend and shake; Pack of 10or 25 —year life span; Weight:0.14-0.17lbs; warranty :min 2 Years si dhe çdo pozicion tjetër që është i kërkuar në specifikacionin teknike Aneksi 1.Ne i jemi përgjigjur kërkesës së AK-së për sqarime dhe i kemi dhënë sqarimet e nevojshme sipas kërkesës. Ne në ofertën tone e kemi bashkangjitur katalogun të cilin na ka dërguar prodhuesi për artikujt e kërkuar, ku në të njëjtin katalog mund të vërtetohet qartë se ne i kemi plotësuar specifikimet teknike. Përveç faktit që produktet tona janë konform specifikimeve teknike, të njëjtat produkte janë edhe më të mira se sa produkti që është kërkuar.Në sqarimet që i ka dhënë prodhuesi dhe katalogun të cilin ne e kemi prezantuar shihet qartë se specifikimet teknike të prezantuara nga ne janë të njëjtat me specifikimet teknike. Ndërsa sa i përket peshës së produktit të cilin e kemi prezantuar me 20 gram, ndërsa pesha e kërkuar nga AK-ja është 63.50 gram, ju sqarojmë se ky fakt nuk përbën ndonjë ndryshim të madh, përkundrazi pesha më e lehtë është edhe më mirë për policët.Duke u bazuar në faktet e lartcekura arsyetimi i eliminimit është i paqëndrueshëm sepse fakti i ndryshimit të peshës përbën devijim të vogël i cili nuk ndikon në substancë dhe në aspektin material, pra ky fakt mund të cilësohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii). Duke pasur parasysh të gjitha sqarimet që u cekën më lartë, kuptohet qartë se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpallemi të përgjegjshëm dhe të rekomandohemi për kontratë.”

Konstatimet dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën 654/23

- *Konstatimi i parë (I)*- Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues “Getno LLC”, ka qenë ofertues i vetëm në këtë aktivitet prokurimi duke ofruar produktet e kërkuara sipas kërkesave nga ana e Autoritetit Kontraktues. OE ankues kishte dërguar katalogun/broshurën me specifikat e detajuara të produkteve të kërkuara nga AK përmes kërkesave për sqarim. Sipas katalogut/broshurës së dorëzuar eksperti sqaron se të gjitha specifikat e tjera të kërkuara në DT përveç peshës kanë qenë të përmbushura nga OE ankues sipas kërkesës. Sa i përket peshës së produkteve, OE përmes broshurës ka treguar se pesha e këtyre dritave është 20 gram përkatësisht këto drita kanë peshë më të lehtë se sa që është kërkuar nga AK, specifikisht që dritat të kenë peshë: 0.14-0.17 lbs apo 63.50293 gram. Duke u bazuar edhe në nenin 59, pika 4 (ii) thotë si më poshtë: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo

devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Mendimi i ekspertit shqyrtues është se një dallim i peshës së dritave të kërkuara në aktivitetin e prokurimit nuk përbënë devijim nga karakteri funksional i dritës siç mund të ishte madhësia e saj, kohëzgjatja e ndriçimit apo rezistenca ndaj ujit. Pësia e dritës konsiderojmë që nuk ndryshon asgjë sa i përket funksionit kryesor të përdorimit të dritës, përkundrazi vlerësojmë se pësia më e lehtë e dritës mund të ketë vetëm efekt pozitiv për përdoruesit. Andaj duke u bazuar në këtë çfarë u sqarua më lartë vlerësojmë se pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar dhe duhet të merret parasysh nga AK, se produkti i ofruar i përmbushë të gjitha kriteret dhe njëkohësisht mund të konsiderohet si produkt më i mirë se ai i kërkuar”.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës nuk janë mjaftueshëm të argumentuara dhe me prova materiale. Prandaj Paneli nuk mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues se pësia e dritës nuk ndryshon asgjë sa i përket funksionit kryesor të përdorimit të dritës dhe se pësia më e lehtë e dritës mund të ketë vetëm efekt pozitiv për përdoruesit dhe këtë AK duhet ta konsiderojë si devijim të vogël konform nenit 59.4 të LPP.

Arsyet e mos mbështetjes së këtij arsyetimi janë se për operatorin ekonomik kanë qenë të njohura specifikat e produktit të kërkuara nga AK përmes Dosjes së Tenderit dhe secili OE ka pasur mundësitë të kërkojë sqarime shpesh dhe të kërkojë lejin e ofertimit të këtij produkti me një peshë tjetër. Meqë OE një gjë të tillë nuk e ka bërë para ofertimit por ka ofertuar me këto kërkesa atëherë ato konsiderohen si kërkesa ligjore dhe të pranueshme për secilin. Megjithatë neni 59.4 të LPP i lejon këto devijime të vogla por këto devijime të cilat kanë të bëjnë me produktin është në përgjegjësi të vetë AK se a i konsideron si të tilla. Eksperti shqyrtues dhe as paneli shqyrtues nuk mund ta detyrojë një AK të konsiderojë si devijim të vogël një produkt i cili nuk është konform kërkesave, nëse vetë AK dhe njësia kërkuuese pranë AK nuk e konsiderojnë, sepse produkti blihet për përdorim dhe nevojave të tyre dhe përgjegjësia është e tyre.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 62 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - GETNO L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: